



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:302284  
Datë: 27.06.2024  
Numri i dokumentit: 05870827

C.nr.10192/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtaren Greta Ibraj, në çështjen juridike kontestimore të paditësve B. P., A.B., dhe Sh.S., të gjithë nga Prishtina, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson B. T., avokat nga Prishtina, ndaj të paditurës Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë, jashtë seancës gjyqësore, me datë 27.06.2024 mori dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësve B. P., A. B., dhe Sh. S., të gjithë nga Prishtina, ashtu që DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës - Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë, t'ua paguaj:

- Paditësit B. P., shumën prej 108.00 € (njëqind e tetë euro), për 54 ditë të punës, për periudhën nga data 30.08.2022 deri me datë 21.11.2022;
- Paditësit A. B., shumën prej 108.00 € (njëqind e tetë euro), për 54 ditë të punës, për periudhën nga data 30.08.2022 deri me datë 21.11.2022; dhe
- Paditësit Sh. S., shumën prej 108.00 € (njëqind e tetë euro), për 54 ditë të punës, për periudhën nga data 30.08.2022 deri me datë 21.11.2022.

Të gjitha këto, me kamatë ligjore prej 8% e cila llogaritet nga dita e paraqitjes së padisë në Gjykatë (datë 28.12.2023), deri në pagesën definitive, brenda afatit prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

II. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve, mbi shumën e gjykuar si në pikën -I- të dispozitivit të këtij aktgjykimi, dhe atë lidhur me kompensimin e kërkuar në emër të shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë, për nga 6 ditë të punës, për periudhën nga data 21.11.2022 e deri më datë 30.11.2022, në shumën prej 12.00 € (dymbëdhjetë euro) për secilin paditës veç e veç, apo në shumën totale prej 36.00 € (tridhjetë e gjashtë euro), si e pabazuar.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 228.00 € (dyqind e njëzet e tetë euro), brenda afatit prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

### A r s y e t i m

Paditësit B. P., A. B., dhe Sh. S., përmes përfaqësuesit të autorizuar të tyre, pranë kësaj Gjykate më datën 28.12.2023, kanë parashtruar padi ndaj të paditurës Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e shpenzimeve të ushqimit për ditët e prezencës në punë. Te njëjtën e kanë precizuar më datë 30.04.2024 dhe 02.05.2024.

Në padi dhe në precizim ndër tjera theksohet se paditësit janë të punësuar tek e paditura në bazë të kontratës së punës, në shkollën fillore të mesme të lartë “7 Sh.”, në Prishtinë. Tutje, theksohet se e paditura nuk e ka bërë kompensimin e shujtave ditore, siç parashihet me Kontratën Kolektive të Arsimit, në nenin 35 pika 7, përkundër faktit se paditësit i plotësojnë kushtet e përfitimit të shujtës ditore. Andaj, mbi bazën e këtyre pretendimeve, në petitum të kërkesëpadiës është propozuar që të aprovohet kërkesëpadia e paditësve dhe të detyrohet e paditura Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Prishtinë, që paditësve, në emër të kompensimit të ushqimit për ditët e pranisë në punë për 60 ditë pune, për periudhën kohore nga data 30.08.2022, deri me datën 30.11.2022, t'ia paguajë secilit paditës veç e veç shumën prej 120.00 €, apo në total shumën prej 360.00 €, me kamatë ligjore prej 8% në vit. Shpenzimet e procedurës i kanë kërkuar.

E paditura përmes përgjigjes në padi, e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve me pretendimin se kompensimet e tilla nuk janë paraparë me Ligjin e Punës, duke shtuar tutje se e paditura gjatë përgatitjes së buxhetit nuk ka paraparë në skemën e saj linjë të veçantë buxhetore për këtë lloj të kompensimit. Po ashtu, ka shtuar se në rastin konkret ekziston edhe parashkrimi i kërkesës, pasi konform dispozitave të LMD-së, të gjitha pagesat mujore, qoftë edhe nga marrëdhënia e punës, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh. Bazuar në këto pretendime, i ka propozuar Gjykatës që pas administrimit të provave, kërkesëpadinë e paditësve ta refuzojë në tërësi si të pabazuar.

Me rastin e pranimit të përgjigjes në padi, gjegjësisht vlerësimit të pretendimeve të palëve e në lidhshmëri me vlerësimin e provave të bashkangjitura, kjo Gjykatë erdhi në përfundim se mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese gjendja faktike, rrjedhimisht nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e një vendimi meritor mbi aprovimin e kërkesëpadiës pa caktuar fare seancë gjyqësore, në kuptim të dispozitës nga neni 398 të LPK-së, e cila përcakton: “*Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.*”

Nga provat e bashkangjitura në padi, Gjykatës i rezulton se paditësit B. P., A. Bërbatovci., dhe Sh. S., janë në marrëdhënie pune me të paditurën, gjegjësisht janë të punësuar në institucionin arsimor SH.M.L. “7 Sh.” në Prishtinë. Paditësi B. P., është i sistemuar në pozitën mësimdhënës, çka vërtetohet sipas Vërtetimit Nr.112/4, të datës 26.04.2024, të lëshuar nga Sekretari i shkollës “7 Shtatori”. Paditësi A. B., është i sistemuar në pozitën roje e natës, rrethanë kjo e cila vërtetohet sipas Vërtetimit Nr.113/4, të datës 26.04.2024, të lëshuar nga Sekretari i shkollës “7Sh.”. Ndërsa, paditësi Sh. S., është i sistemuar në pozitën roje e natës, rrethanë kjo e cila vërtetohet sipas Vërtetimit Nr.114/4, të datës 26.04.2024, të lëshuar po ashtu nga Sekretari i shkollës “7 Sh.”, institucion ku janë të punësuar tre paditësit. Po ashtu, nga vërtetimet e lartcekura, vërtetohet edhe fakti se përgjatë periudhës kohore nga data 30.08.2022 deri më datë 30.11.2022, secili nga paditësit kanë qenë prezent në vendin e tyre të punës për 60 ditë pune. Provave materiale të lartcekura, Gjykata ua fali besimin e plotë në kuptim të dispozitës nga neni 329 par.1 të LPK-së, e cila përcakton se: *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të.”*

Lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë, Gjykata vlerëson se në rastin konkret duhet të aplikohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021. Kjo për faktin se kërkesëpadia e paditësve për kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë, përfshinë periudhën kohore nga data 30.08.2022 e deri me datën 30.11.2022, andaj e njëjta gjenë mbështetje në Kontratën Kolektive të Arsimit, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2022.

Çështja e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë, parashihet me dispozitën nga neni 35 par.7 të Kontratës së lartcekur, ku është përcaktuar se: *“Të punësuarve (anëtarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim pagese, të të punësuarve për ushqim”.*

Mbi këtë bazë, Gjykata vlerëson se paditësit janë të legjitimuar të kërkojnë përmbushjen e detyrimit nga e paditura përmes rrugëve gjyqësore, respektivisht është krijuar marrëdhënia e detyrimit mes palëve ndërgjyqëse, në kuptim të dispozitës nga neni 245 të Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku parashihet *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”.*

Referuar dispozitave të lartë cekura, Gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është në pjesërisht e bazuar, andaj mbi këtë bazë është bërë përlllogaritja në atë mënyrë që ditët e pranisë në punë i ka shumëzuar me 2 euro për ditë pune, e bazuar në faktin se nga provat e administruara u vërtetua se paditësit për periudhën kohore të specifikuar në pikën I të dispozitivit

të këtij aktgjykimi, secili veç e veç kanë nga 54 ditë të prezencës në punë, të njëjtëve iu takon kompensimi në shumë prej 108.00 € secilit, apo në shumën e përgjithshme prej 324.00 €. Bazuar në këto konstatime, u vendos si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Lidhur me vendosjen si në pikën -II- të dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata vlerësoi se sa i përket kërkesëpadisë së paditësve për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë, për periudhën 22.11.2022 e deri më 30.11.2023, mungon baza ligjore e mbështetjes së kërkesëpadisë, andaj edhe këtë pjesë të kërkesëpadisë së paditësve e refuzoi si të pa bazuar.

Me rastin e vendosjes si në pikën -II- të dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata pati parasysh faktin se Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, e nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në njërën anë, dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës në anën tjetër, ka hyrë në fuqi ditën e nënshkrimit, më datë 22.01.2021. Megjithatë, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, si palë kontraktuese, më datë 21.11.2022 ka njoftuar shkëputjen e kësaj kontrate dhe atë para skadimit të afatit të vlefshmërisë së të njëjtës. Duke qenë se pala tjetër kontraktuese, konkretisht Sindikata, deri më tani nuk ka dëshmuar të ketë marrë ndonjë hap në drejtim të kontestimit të shkëputjes së njëanshme të kontratës, apo të ketë shfrytëzuar mekanizmat e paraparë me kontratën në fjalë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes tyre, Gjykata vlerëson se kjo Kontratë ka pasur vlefshmëri dhe ka prodhuar efekt juridik vetëm deri në datën e tërheqjes së Ministrisë nga kontrata (datë 21.11.2022). Përkitazi me këtë vlerësim, Gjykata iu referua edhe Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës GJ.A.Su.A.nr.214/2023, të datës 09.10.2023 (shih: pika III e këtij mendimi juridik).

Gjykata me rastin e vendosjes i vlerësoi pretendimet e ngritura nga ana e të paditurës përmes përgjigjes në padi, që përqendrohen në tri rrethana: fillimisht në faktin që kompensimet e tilla nuk janë paraparë me Ligjin e Punës, se gjatë përgatitjes së buxhetit, nuk është paraparë linjë e veçantë buxhetore për këto lloje kompensimit si dhe pretendimi se kërkesëpadia e paditësit në rastin konkret është e parashkruar.

Sa i përket pretendimit të parë, Gjykata vlerëson se e drejta e paditësve për të përfituar një kompensim të tillë nga marrëdhënia e punës është paraparë me dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit, e cila buron pikërisht nga dispozitat e Ligjit të Punës, ku në nenin 3 par.1, pika 1.8 e këtij ligji përcaktohet: *“Kontrata Kolektive - marrëveshja ndërmjet organizatave të punëdhënësve dhe organizatave të të punësuarve me të cilën rregullohen të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga marrëdhënia e punës sipas marrëveshjes së arritur”*. Në mënyrë më specifike, kushtet lidhur me vlefshmërinë e kësaj Kontrate, janë të përcaktuara me dispozitën e nenit 90 të Ligjit të Punës. Në këtë mënyrë, meqë sipas Kontratës Kolektive të lart cekur, në njërën anë janë paraparë të drejta për njërën palë, e në anën tjetër janë marrë përsipër obligime nga pala tjetër, rrjedh se e drejta e paditësve për të përfituar një kompensim të tillë nga marrëdhënia e punës, në mënyrë indirekte derivon nga dispozitat e Ligjit të Punës.

Pretendimin lidhur me mungesën e një linje të veçantë buxhetore për kompensimet e tilla, Gjykata po ashtu e vlerëson pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje, për faktin se një rrethanë e tillë nuk mund të konsiderohet pengesë që paditësit t'i realizojnë të drejtat e

garantuara me Kontratë Kolektive, dispozitat e së cilës janë të karakterit obligativ, mbi bazën e plotësimit të kushteve dhe ekzistimit të rrethanave të cilave Gjykata i është referuar më sipër në arsyetim të këtij aktgjykimi.

Po ashtu, Gjykata e vlerëson si të pa bazuar dhe të qëndrueshëm edhe pretendimin e të paditurës mbi parashkrimin e kërkesës konform dispozitave të LMD-së, ku përcaktohet se ndër tjera të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh. Kjo, për faktin se kërkesëpadia e paditësit përfshinë periudhën nga data 30.08.2022 e deri më datë 30.11.2022, ndërkaq padia është parashtruar më datë 28.12.2023, do të thotë pa kaluar afati 3 vjeçar i parashkrimit. Mbi këtë bazë, Gjykata vlerësoi se një pretendim i tillë i të paditurës nuk kishte ndikim për një vendosje ndryshe nga ç'është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me kumatën ligjore prej 8% në vit, Gjykata ka vendosur konform nenit 382 par.1 lidhur me par.2 të LMD-së, duke e obliguar të paditurën që shumën e gjykuar në pikën I të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, të ia paguajë së bashku me kumatë ligjore prej 8% në vit, e cila kumatë do të fillojë të llogaritet nga dita e paraqitjes së padisë në Gjykatës, e deri në pagesën definitive të shumës si në pikën I të dispozitivit.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, nga pika II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata e mbështeti në dispozitën nga neni 453, 452 par.1 e lidhur me nenin 463 par.1 LPK-së, duke e obliguar të paditurën që paditësve t'ua kompensojë shumën e tërësishme të shpenzimeve të nevojshme deri në këtë fazë të procedurës në vlerë të përgjithshme prej 228.00 € dhe atë: 208.00 € në emër të përpilimit të padisë dhe 20.00 € në emër të taksës për padi. Sa i përket shumës së shpenzimeve të aprovuara, Gjykata iu referua Tarifës së Odës së Avokatëve (numrit tarifor 6).

Bazuar në të lartë cekurat, në bazë të nenit 398 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil  
C.nr.10192/2023, më datë 27.06.2024

Gjyqtarja  
Greta Ibraj

---

*KËSHILLË JURIDIKE:* Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të dorëzohet në kopje të mjaftueshme për Gjykatën dhe palët.